



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 1800/1 prot.

Tiranë, më 16.7.2025

VENDIM

Nr. 21, datë 16.7.2025

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1800 Prot., datë 14.07.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Shoqërisë “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k.

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 07.07.2025, ka kërkuar të informohet nëse z. , plotëson të gjitha kriteret formale dhe ligjore të kualifikimit profesional, të kërkuara për pozicionin “Teknik i Lartë Mekanik”, sipas standarteve të kompanisë.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Shoqëria “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën për informacion, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që*

ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”, ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative, “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k. Nga verifikimi rezulton se, “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k., është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit J61901061H. Referuar ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 100% aksione private. Ndërkohë, objekti i LDI, është garantimi i njohjes së publikut me *informacion/dokumentacion publik*, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e LDI “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënese, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Shoqëria “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k., nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1800 prot., datë 14.07.2025, të z. _____, kundër Shoqërisë “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA” sh.p.k., me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 16.7.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi